



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr.262/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Drejtoreshës së shërbimeve komunale në Komunën e Graçanicës Jelena Stojanović, paraqitur kundër subjekteve politike dhe simpatizantëve të tyre lidhur me veprimet e ndaluara për subjektet politike për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 25.10.2013, mori këtë:

**VENDIM**

**Miratohet** si e bazuar ankesa e Jelena Stojanović, drejtoreshë e shërbimeve komunale në Komunën e Graçanicës, kështu që subjektit politik G.I Srpska (G.I.S), dega në Graçanicë, i shqiptohet dënimi më gjohë në vlerë prej 400 (katërqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datën 16.10.2013, nga Jelena Stojanović, drejtoreshë e shërbimeve komunale në Komunën e Graçanicës, në të cilën theksohet se ishte e detyruar të reagoj në bazë të detyrës zyrtare, sepse infrastruktura në komunën e lartëpërmendur është në gjendje të keqe për shkak të vendosjes së posterave në shenja të trafikut, në objekte dhe godina publike të cilat janë në pronë të komunës. Më tutje theksohet se shërbimi teknik i komunës disa herë ka intervenuar duke dalë në teren dhe duke hequr posterat nga vendet ku sipas ligjit është e ndaluar vendosja e tyre, mirëpo edhe pas shkresës së parë të dorëzuar edhe pas intervenimit të punëtorëve në teren gjendja nuk është ndryshuar, theksohet në ankesë. Poashtu parashtruesja e ankesës thekson se nuk respektohet Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe kodi i mirësjelljes nga subjektet politike dhe simpatizuesit e tyre, dhe si drejtoreshë e sektorit të shërbimeve komunale thekson se përpiket që ta ruaj pronën e komunës, të evitoj dëmtimet e infrastrukturës dhe ta parandaloj rrezikimin e sigurisë të të gjithë pjesëmarrësve në trafik. Parashtruesja e ankesës kërkon që në përputhshmëri me ligjin të reagoj ndaj subjekteve politike sloganet dhe posteret e të cilave shihen në fotografitë, të cilat i janë bashkangjitur ankesës.

PZAP-i, e informoi subjektin politik G.I. Srpska, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, më datë 17.10.2013, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 19.10.2013, në ora 12:00.

Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, pranoi përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik G.I. Srpska, në të cilën deklaroi se ankesa është e pabazuar, ngase objekti mbi të cilin është vendosur materiali zgjedhor është selia e Ndërmarrjes Publike Komunale "Komunalac", Prishtinë me seli në Graçanicë, themeluesi i kësaj ndërmarrje është Kuvendi i qytetit të Prishtinës, e kuvendi i qytetit të Prishtinës me selinë e zhvendosur në Graçanicë, funksionon në bazë të sistemit të Republikës së Serbisë, kështuqë pronat që përdoren nga institucionet që funksionojnë në bazë të sistemit të Republikës së Serbisë, ligjet e Kosovës nuk i trajtojnë si pronë e shërbimeve publike komunale dhe nuk janë pjesë e objekteve mbi të cilët është ndaluar vendosja e materialeve zgjedhore, theksohet në përgjigjen në ankesë. Poashtu G.I. Srpska i mohon të gjitha pretendimet ankimore nga Komuna e Graçanicës e cila pa ndonjë dëshmi dhe me qëllime tendencioze e akuzon G.I. Srpska duke theksuar se prona e Republikës së Serbisë, sipas mendimeve të tyre është prona e komunës së Graçanicës.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

Nga fotografia e ofruara si provë e cila gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se si poster i kandidatit për kryetar të Komunës së Graçanicës nga subjekti G.I. Srpska është i vendosur në objekt publik, gjë që e bën përgjegjëse subjektin politik G.I. Srpska, veprime këto të cilat janë në kundërshtim me nenin 4.1 pika b) të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenin 33 pika b) të LZP-së të cilat përcaktojnë veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Në përgjigje të ankesës nga subjekti politik G.I. Srpska, përveç thënieve se poster i kandidatit të këtij subjekti është vendosur në ndërmarrje publike të themeluar nga Kuvendi i qytetit të Prishtinës dhe i cili funksionon në bazë të sistemit të Republikës së Serbisë, nuk ka ofruar asnjë dëshmi që ka ndërmarr veprime konkrete për evitimin e shkeljes së supozuar.

PZAP-i nga dëshmitë e ofruara konstatoi se nga ana e subjektit politik G.I.Srpska, është shkelur neni 33. pika b) e LZP-së, si dhe neni 4.1 pika b) e Rregullës Zgjedhore Nr.11/2013, ngase nga fotografia e ofruar si dëshmi që gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë posteri i kandidahtit për kryetar nga subjekti politik G.I.Srpska, është i vendosur në ndërtesë publike. Prandaj nga të gjitha arsyet e lartshënuara si dhe duke marr parasysh faktorët e cituar më lart për përcaktimin e lartësisë së gjobës, në kuptim të nenit 3.2 të Rregullës 01/2012 të PZAP-it, nenit 120 paragrafi 1 pika (c), si dhe nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrsa**

Anr. 262/2013 më datën 25.10.2013.

**Kryesuesi i Panelit  
Muhamet Rexha**



***Këshillë Juridike:*** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*